

Deklaratë e përbashkët ndër-komunale


për të promovuar dialogun ndërmjet komuniteteve në komunat e Pejës, Gjakovës, Deçanit, Klinës, Istogut dhe Junikut

Ne, kryetarët e Pejës, Gjakovës, Deçanit, Klinës, Istogut dhe Junikut, publikisht e nënshkruajmë këtë deklaratë të përbashkët për angazhimin tonë për të promovuar dialogun dhe respektin ndërmjet komuniteteve në komunal tona dhe në tërë Kosovën.


Lidhur me këtë, ne:

- Rikujtojmë se një shoqëri me shumëllojshmëri kulturore është një qëllim që duhet ndjekur, dhe se ndërtimi i institucioneve është po aq i rëndësishëm sa edhe krijimi i bashkëpunimit gjithnjë e më të afërt në të gjitha fushat dhe në respekt të të gjitha komuniteteve;
- Nxism komunitetet e Kosovës që të mbështesin një projekt të përbashkët dhe të respektojnë identitetet nacionale dhe të komuniteteve, të jenë të hapur për të gjithë, si dhe të luftojnë të gjitha llojet e kërcënimeve që paraqiten për demokracinë dhe të drejtat e njeriut në Kosovë;
- Mendojmë se pajtimi ndërmjet komuniteteve, kthimi dhe ri-integrimi, respekti i ndërsjellë dhe dialogu janë vendimtare për krijimin e një Kosove të qëndrueshme dhe demokratike;
- Pajtohemi për të vazhduar luftën tonë kundër të gjitha formave të diskriminimit dhe përjashtimit shoqëror, si dhe akteve të urrejtjes, të cilat minojnë parimet demokratike të Kosovës;
- Zotohemi për të emëruar përfaqësues nga secila komunë për të komunikuar dhe përpiluar në mënyrë të rregullt aktivitete që do të kenë për qëllim promovimin aktiv të dialogut dhe ndërveprimit ndërmjet komuniteteve;
- Synojmë që të rrisim veprimin tonë individual për të siguruar që Kosova dhe institucionet e saj të jenë më afër shqetësimeve të të gjithë komuniteteve, duke kontribuar kështu për një Kosovë me shumë komunitete dhe demokratike;
- Ftojmë OSBE-në, organizatat tjera ndërkombëtare, institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës si dhe qeveritë e të gjitha shtetëve, për të vazhduar mbështetjen e tyre për zhvillimin dhe rritjen e një shoqërie të larmishme në Kosovë, të projektuar për të siguruar që vlerat dhe praktikat e të drejtave të njeriut kanë zënë vend në zbatimin e përditshëm;
- Shprehim solidaritetin tonë me kolegët tanë nga të gjitha komunitetet e Kosovës dhe shpresojmë se iniciativa të tillë do të ndërmerren në mbarë Kosovën për të promovuar në mënyrë aktive pajtimin dhe për të sjellë Kosovën në grupin e demokracive Evropiane sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Shprehim mirënjojen tonë për Misionin e OSBE-së në Kosovë, si dhe për të gjithë stafin, për organizimin e shkëlqyer të kësaj konferencë në Prizren.

Z. Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës së Pejës




Z. Ardian Gjini
Kryetar i Komunës së Gjakovës




Z. Bashkim Ramosaj
Kryetar i Komunës së Deçanit



Z. Zenun Elezaj
Kryetar i Komunës së Klinës



Z. Haki Rugova
Kryetar i Komunës së Istogut



Z. Agron Kuçi
Kryetar i Komunës së Junikut

